

Data 10/10/2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mallra**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

“Blerje materiale elektrike për nevojat e NPP(koka ndricimi LED dhe kablllo elektrike)”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

**34993000-4-Ndricules rrugorë**

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 4,995,000(katër milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë)LEKË PA TVSH **vënë në dispozicion nga Buxheti i shtetit.**

**Vlera e fondit limit është percaktuar bazuar ne mesataren e tre ofertave te marra nga grupi i punes i ngritur me Urdherin Nr 145.prot date 10/10/2024 konform nenit 34,35,36 te Ligjit Nr 162/2023 “Per Prokurimin Publik”.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor, Ndërmarrja e Pasurisë Publike, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin76 ”Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe ne mbeshtetje te Nenit 26”Formulari përmbledhës i

vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik*”.

Neni 83 i LPP “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”,

### **1.2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

- EN-ISO 9001-2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

**Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 79 te Ligjit 162/2021 “Për Prokurimin Publik” dhe në nenin 44 te Vendimit Nr.285 19.05.2021 të cilët përcaktojnë se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

- Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2021 ,2022, 2023) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.
- Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.
- Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" në të cilin gjejmë te përcaktuar se: " Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar.. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.;, , si dhe pikat 1,2 pika c) ,3 te nenit 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kërkuara, se zoterojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar,. Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

- **2.2.2** Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit (**2021, 2022, 2023**), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit
- **2.2.3** Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2024**, pranë njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi, në përputhje me ligjin 9632 datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" kudo që operatori ekonomik ka ushtruar aktivitetin sipas QKB. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, ”..Gjithashtu Autoritetet ose Entet Kontraktore mund të kërkojnë që Operatorët ekonomik të japin informacione në Bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndermjet aktivitet dhe pasivitet” LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr.9920 date 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më pak se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe mallrat e furnizuara

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe mallrat e furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

**3.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi/distributori për mallrat, objekt prokurimi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit si: telefon, f Në rastin e autorizimit të distributorit, duhet paraqitur dhe marreveshja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Secili nga dokumentat e paraqitur duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website në rast verifikimi nga ana e autoritetit kontraktor ax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të garantojnë Autoritetin Kontraktor për disponueshmërinë apo furnizimin me materialet kryesore që nevojiten për realizimin e punimeve objekt i kontratës.

**4.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog ose/dhe skeda teknike për të gjithë mallrat objekt prokurimi, të shoqëruara me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe, ku të jepen të gjitha karakteristikat teknike të tyre, me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”nenit 40, pika 6, gërma b,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

**5.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, për të gjitha mallrat objekt prokurimi, në formën e një table sipas modelit të mëposhtëm, e cila duhet të plotësohet në mënyrë rigoroze. Oferta teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë;

a. Emri i kompanisë prodhuese

b. Emërtimi i Katalogut të prodhuesit ose i skedës teknike

c. Numri i faqes në katalog ose në skedën teknike ku ndodhet artikulli

d. Numri (kodi) identifikues i artikullit të ofruar, i shënuar me një shenjë dalluese.

NR	Emri i kompanisë prodhuese	Emri i katalogut prodhuesit	Nr i faqes	Nr i artikullit

**Të dhënat e deklaruara në ofertën teknike duhet të korespondojnë me të dhënat për artikujt në katalogët/skedat teknike të dorëzuara.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”nenit 40, pika 6, gërma b,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

Ofertuesi i kualifikuar i pari duhet te dorëzoje përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe brenda afatit te percaktuar ne kerkesen per dorezim dokumentacioni prane AK, dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të parashikuara në pikën 2 të nenit 26 te VKM-se 285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

**Njësia e Prokurimit:**